



Data	
Nr. Prot	

**RELACION**

**PËR PROJEKTVENDIMIN**

**PËR**

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË MALIQ, ME  
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E “PARTISË DEMOKRATIKE TË  
SHQIPËRISË”, ZJ. MARJETA MUHAMER XHELOLLARI**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Me shkresën nr. 1337 prot., datë 5.3.2024, Këshilli i Bashkisë Maliq, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga Këshilltari, zj. Aleksandra Murat Spaho, propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Demokratike e Shqipërisë”.

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e “Partisë Demokratike të Shqipërisë”, për Këshillin e Bashkisë Maliq, të cilit i kalon mandati i Këshilltarit, është kandidati me numër rendor 4, zj. Marjeta Muhamer Xhelollari.

Me shkresën nr. 709, prot., datë 11.3.2024, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Maliq, zj. Marjeta Muhamer Xhelollari, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Këshillin Bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e Këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për Këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit Partia Demokratike e Shqipërisë, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër KO\_PDSH-12869\_1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i Këshilltarit të Bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zj. Marjeta Muhamer Xhelollari, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016 me shkresën nr. 805 prot., datë 25.3.2024, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe me shkresën nr. 807 prot., datë 25.3.2024, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore për zj. Marjeta Muhamer Xhelollari.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë, për verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar zj. Marjeta Muhamer Xhelollari, në Këshillin e Bashkisë Maliq.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 4431/1 prot., datë 28.3.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për zj. Marjeta Muhamer Xhelollari, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Marjeta Muhamer Xhelollari, në Këshillin e Bashkisë Maliq, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e Këshilltarit.

<b>Jona JOSIFI</b>	-Drejtorja e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit
<b>Majlinda ÇELMETA</b>	-Drejtorja e Përgjithshme e Administrimit të Zgjedhjeve
<b>Ylli MERKAJ</b>	-Sekretar i Përgjithshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

Data: DD MM VVVV

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

**PROJEKTVENDIM**

**PËR**

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË MALIQ, ME  
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E “PARTISË DEMOKRATIKE TË  
SHQIPËRISË”, ZJ. MARJETA MUHAMER XHELOLLARI**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

**VËREJ:**

Me shkresën nr. 1337 prot., datë 5.3.2024, Këshilli i Bashkisë Maliq, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zj. Aleksandra Murat Spaho, propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Demokratike e Shqipërisë”.

Referuar nenit 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e “Partisë Demokratike të Shqipërisë”, për Këshillin e Bashkisë Maliq, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 4, zj. Marjeta Muhamer Xhelollari.

Me shkresën nr. 709, prot., datë 11.3.2024, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Maliq, zj. Marjeta Muhamer Xhelollari, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit “Partia Demokratike e Shqipërisë”, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër KO\_PDSH-12869\_1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për

Data: dd mm vvvv Nr: 123-456  
Ora: hh:mm



“Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Maliq me kandidatin nga lista shumemërore e “Partisë Demokratike të Shqipërisë”, zj. Marjeta Muhamer Xhelollari”.

administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zj. Marjeta Muhamer Xhelollari, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, me shkresën nr. 805 prot., datë 25.3.2024, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe me shkresën nr. 807 prot., datë 25.3.2024, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore për zj. Marjeta Muhamer Xhelollari.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë, për verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar zj. Marjeta Muhamer Xhelollari, në Këshillin e Bashkisë Maliq.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 4431/1 prot., datë 28.3.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për zj. Marjeta Muhamer Xhelollari, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Marjeta Muhamer Xhelollari, në Këshillin e Bashkisë Maliq, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

### **V E N D O S:**

1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Maliq, me kandidatin nga lista shumemërore e “Partisë Demokratike të Shqipërisë”, zj. Marjeta Muhamer Xhelollari.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**